



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 1616/1 Prot

Tiranë, më 21.11.2019

V E N D I M

Nr.147, datë 21.11.2019

“Mbi përfundimin e verifikimit të kryer në institucionin e qeverisjes vendore Bashkia Bulqizë, të filluar me urdhrin nr. 65, datë 12.9.2019, të Komisionerit, në lidhje me evidentimin e rasteve të emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil, si dhe zbatimin e standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, në përputhje me parimet e ligjit për nëpunësin civil, në këtë bashki”.

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me verifikimin e kryer në njësinë e vetëqeverisjes vendore Bashkia Bulqizë,

VËREJ SE,

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me qëllim mbikëqyrjen e zbatimit të ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në lidhje me emërimet në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, si dhe zbatimin e standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, si pjesë e rëndësishme e strukturës organizative të institucionit, me urdhrin nr. 65, datë 12.9.2019, “Për fillimin e procesit të inspektimit në lidhje me rastet e emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil në njësitë e vetëqeverisjes vendore, si dhe verifikimi i zbatimit të standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, si pjesë e rëndësishme e strukturës organizative të institucionit në përputhje me parimet e ligjit për nëpunësin civil”, ka nisur kryesisht procesin e verifikimit në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore (61 bashkitë e vendit), ku përfshihet edhe Bashkia Bulqizë.

Verifikimi u realizua nëpërmjet vizitës në subjekt nga grupi i inspektimit, i autorizuar nga Komisioneri për këtë qëllim. Nga aktet e administruara gjatë inspektimit në subjekt, ka rezultuar se, Bashkia Bulqizë, është e organizuar dhe funksionon në bazë të strukturës dhe organikës të miratuar me vendimin nr. 2, datë 14.1.2019 të Kryetarit të Bashkisë Bulqizë “*Mbi miratimin e strukturës/ organikës/ kategoritë/ nivelin e pagave/ klasën e pagave për çdo pozicion të administratës së bashkisë, ndërmarrjeve dhe njërive shpenzuese në varësi të Bashkisë Bulqizë për vitin 2019*”, i ndryshuar me vendimet nr. 12, datë 6.2.2019 dhe nr. 47, datë 11.4.2019.

Sipas strukturës në fuqi, Bashkia Bulqizë, së bashku me njësitë administrative në përbërje të saj, ka gjithsej **70** pozicione pune të vlerësuara si pjesë e shërbimit civil, të cilat sipas kategorive të shërbimit civil klasifikohen: **1** pozicion i kategorisë së lartë drejtuese, **8** pozicione të kategorisë së mesme drejtuese, **9** pozicione të kategorisë së ulët drejtuese dhe **52** pozicione të kategorisë ekzekutive.

Në strukturën organizative të Bashkisë Bulqizë janë evidentuar pozicione pune, të cilat për nga emërtesa konsiderohen si pozicione të shërbimit civil, për faktin se në strukturë shoqërohen me emërtesën “*Specialist*”. Konstatohet se, këto pozicione, pavarësisht emërtesës, janë trajtuar nga njësia përgjegjëse si funksione administrative, jashtë shërbimit civil, nisur nga kompetencat dhe detyrat funksionale që ato kryejnë, si dhe kategorisë së pagës aplikuar për këto pozicione.

Në kuptim të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, si dhe vendimit nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*”, i ndryshuar, me miratimin e strukturës së ardhshme të institucionit, pozicionet e punës, të cilat kryejnë funksione administrative dhe nuk ushtrojnë autoritet publik, nuk duhet të shoqërohen me emërtesën “*Specialist*”, me qëllim diferencimin e tyre nga pozicionet e shërbimit civil.

Në momentin e kryerjes së këtij verifikimi, në Bashkinë Bulqizë u evidentuan **10** pozicione pune të shërbimit civil, të plotësuar me punonjës të punësuar me akt emërimi të përkohshëm të nxjerrë nga titullari i institucionit, në kundërshtim me ligjin, ku **1 rast**, është emërim në pozicion të kategorisë së mesme drejtuese pa u zbatuar procedurat e ngritjes në detyrë të parashikuara nga neni 26 i ligjit dhe **9 raste**, janë emërimet në pozicione të kategorisë ekzekutive pa u zbatuar procedurat e pranimit në shërbimin civil të parashikuara nga nenet 22 e 23 të ligjit.

Emërimet në kundërshtim me ligjin, në bazë të aktit të nxjerrë nga titullari i institucionit, evidentohen si më poshtë:

1. ******, “Drejtor në Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore”, akti nr. 3141, dt. 8.8.2019, (*kjo punonjëse e ka emërimin e rregullt në shërbimin civil në pozicionin “Specialist i Prokurimeve Publike”, konfirmuar nëpunës civil në këtë pozicion me aktin nr. 85, dt. 8.6.2018 të drejtorisë së burimeve njerëzore*).

2. *****, “Specialiste e Kadastrës dhe Topograf”, në Drejtorinë e Planifikimit të Territorit, Kontrollit të Projekteve, Mjedisit dhe MAT, akti nr. 3140, dt. 8.8.2019.
3. *****, “Specialiste në Njësinë për Koordinimin e Integritit Europian dhe Ndhmës së Huaj”, akti nr. 99, dt. 9.8.2019.
4. *****, “Specialiste e regjistrimit dhe vlerësimit të subjekteve”, në Sektorin e Taksave dhe Tarifave Vendore, akti nr. 122, dt. 11.9.2019.
5. *****, “Specialist i Pronave, Njësia Administrative Ostren”, në Sektorin e Menaxhimit të Pronave, akti nr. 56, dt. 26.4.2019.
6. *****, “Inspektore Auditit”, në Njësinë e Auditimit të Brendshëm, akti nr. 65, dt. 17.5.2019.
7. *****, “Specialiste ekonomie”, në Drejtorinë e Shërbimit Social, akti nr. 10, dt. 27.5.2019.
8. *****, “Specialist i prokurimeve publike”, në Drejtorinë Juridike dhe Prokurimeve Publike, akti nr. 30, dt. 26.3.2019.
9. *****, “Specialist Finance për asetet”, në Drejtorinë e Financës, akti nr. 16, dt. 14.2.2019.
10. *****, “Specialist në Njësinë për Koordinimin e Integritit Europian dhe Ndhmës së Huaj”, akti nr. 66, dt. 21.5.2019.

Komisioneri evidenton se, aktet e mësipërme të emërimit, kanë dalë në kundërshtim me ligjin, pasi, për çdo marrëdhënie të re pune, që lidhet pas fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, në bazë të nenit 22, 23, 25 dhe 26 të tij, duhet të respektohen detyrimisht, kërkesat e një procedure të rregullt konkurrimi. Çdo akt administrativ i nxjerrë në kundërshtim me këtë rregull, në vështrim të nenit 108, pikat i) dhe ii) të shkronjës “a” dhe shkronjës “ç”, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, është absolutisht i pavlefshëm.

Për më tepër, ndalimi i emërimit në kundërshtim me procedurën për pozicionet e nivelit ekzekutiv, është theksuar shprehimisht në pikën 4, të nenit 23, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, për të mos lejuar subjektivitet apo keqinterpretime në implementimin e kësaj dispozite në praktikë.

Në vijim të këtij arsytimi, në bazë të nenit 110, pika 1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, veprimi administrativ absolutisht i pavlefshëm nuk sjell asnjë pasojë juridike, pavarësisht faktit nëse është konstatuar apo jo si i tillë.

Nisur nga detyrimi i parashikuar nga neni 111, i ligjit në fjalë, vetë organi publik, në këtë rast Kryetari i Bashkisë Bulqizë, duhet të konstatojë në këto veprime administrative, ekzistencën e rasteve të parashikuara në nenin 108, të ligjit si më lart, dhe në bazë të pikës 1, të nenit 111, të po këtij ligji, të konstatojë menjëherë pavlefshmërinë absolute të këtyre akteve dhe të rregullojë pasojat duke ndërprerë marrëdhënien e punës të lidhur në kundërshtim me procedurat ligjore dhe

më tej, duke i shpallur si të lira këto pozicione, për t'u plotësuar në përputhje me ligjin për nëpunësin civil.

Pozicionet në fjalë, duhet të plotësohen me anën e procedurave të konkurrimit të hapur, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, dhe akteve nënligjore dalë për zbatim të tij, apo nëpërmjet procedurave të lëvizjes paralele dhe të ngritjes në detyrë.

Njësia përgjegjëse, gjatë zhvillimit të procedurave të konkurrimit, duhet të kujdeset të përmbushë rregullat e përcaktuara në kreun IV *“Pranimi në shërbim civil”*, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, vendimin nr. 242, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave *“Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”* dhe vendimin nr. 243, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, *“Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”*, si dhe udhëzimin nr. 2, datë 27.3.2015, të Departamentit të Administratës Publike *“Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”*.

Duke u nisur nga rrethanat e evidentuara më sipër, njësia përgjegjëse duhet të kujdeset që të realizojë procedurat e rekrutimit në grup, në nivelin ekzekutiv, duke pasur në vëmendje pikën 8, të nenit 19, të ligjit për nëpunësin civil, e cila i klasifikon pozicionet e punës në grupet e pozicioneve të administrimit të përgjithshëm dhe grupet e pozicioneve të administrimit posaçëm.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, referuar seksionit III, *“Procedura hetimore”*, të ligjit nr. 44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, si dhe Rregullores *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me vendimnr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

V E N D O S A:

1. Të kërkoj nga Kryetari i Bashkisë Bulqizë, me synim rregullimin e situatës së ligjshmërisë së administrimit të shërbimit civil, të konstatojë menjëherë, si akte administrative absolutisht të pavlefshëm, rastet e emërimit të punonjësve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil, të evidentuara si më poshtë:

- ✓ *****, *“Drejtor në Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore”*, akti nr. 3141, dt. 8.8.2019.
- ✓ *****, *“Specialiste e Kadastrës dhe Topograf”*, në Drejtorinë e Planifikimit të Territorit, Kontrollit të Projekteve, Mjedisit dhe MAT, akti nr. 3140, dt. 8.8.2019.

- ✓ *****, “Specialiste në Njësinë për Koordinimin e Integritit European dhe Ndhmës së Huaj”, akti nr. 99, dt. 9.8.2019.
 - ✓ *****, “Specialiste e regjistrimit dhe vlerësimit të subjekteve”, në Sektorin e Taksave dhe Tarifave Vendore, akti nr. 122, dt. 11.9.2019.
 - ✓ *****, “Specialist i Pronave, Njësia Administrative Ostren”, në Sektorin e Menaxhimit të Pronave, akti nr. 56, dt. 26.4.2019.
 - ✓ *****, “Inspektore Auditi”, në Njësinë e Auditimit të Brendshëm, akti nr. 65, dt. 17.5.2019.
 - ✓ *****, “Specialiste ekonomie”, në Drejtorinë e Shërbimit Social, akti nr. 10, dt. 27.5.2019.
 - ✓ *****, “Specialist i prokurimeve publike”, në Drejtorinë Juridike dhe Prokurimeve Publike, akti nr. 30, dt. 26.3.2019.
 - ✓ *****, “Specialist Finance për asetet”, në Drejtorinë e Financës, akti nr. 16, dt. 14.2.2019.
 - ✓ *****, “Specialist në Njësinë për Koordinimin e Integritit European dhe Ndhmës së Huaj”, akti nr. 66, dt. 21.5.2019.
2. Punonjësja *****, e emëruar me ngritje në detyrë pa u zbatuar procedurat e parashikuara nga neni 26 i ligjit, të rikthehet në pozicionin e punës ku ka emërimin e rregullt në shërbimin civil. Nëse është e pamundur rikthimi në vendin e mëparshëm të punës, të bëhet sistemimi në një pozicion tjetër të shërbimit civil, të së njëjtës kategori ku ajo i plotëson kërkesat specifike për vendin e punës.
 3. Të kërkoj nga njësia përgjegjëse që për të gjitha pozicionet e shërbimit civil, të cilat në kuptim të ligjit janë vende vakante, të hartohen përshkrimet e punës sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara në vendimin nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar.
 4. Njësia përgjegjëse, të shpallë menjëherë për t’u plotësuar pozicionet e shërbimit civil që, në kuptim të ligjit, janë vende vakante dhe ato të plotësuar në kundërshtim me ligjin dhe më tej, të vijojë realizimi i procedurave të konkurrimit, duke realizuar procedurën e rekrutimit në grup për kategorinë ekzekutive, sipas strukturës që është në fuqi në momentin e zbatimit të detyrave të këtij vendimi.
 5. Njësia përgjegjëse e Bashkisë Bulqizë, në momentin e miratimit të strukturës së ardhshme për vitin 2020, të tregoj kujdes në krijimin e një strukture, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, duke evituar përdorimin e emërtesës “Specialist”, për pozicionet e punës të cilat nuk përfshihen në skemën e shërbimit civil.

6. Institucioni të përgatitë dhe të miratojë planin e nevojave për rekrutimin në shërbimin civil për vitin e ardhshëm, për të gjitha pozicionet e mbetura vakant deri në shkurt të vitit 2020, duke respektuar procedurat dhe afatet e përcaktuara në vendimin nr. 108, datë 26.2.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”.
7. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **3 (tre) muaj**, nga marrja dijoni për këtë vendim. Institucioni i inspektuar dhe njësia përgjegjëse, duhet të zbatojnë këtë vendim, duke u bazuar në orientimet e dhëna në pjesën arsyetuese të tij.

Me kalimin e këtij afati, subjekti i mbikëqyrur, njësia e vetëqeverisjes vendore Bashkia Bulqizë, duhet të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.

8. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjositjes së nëpunësit përgjegjës për moszbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.
9. Për këtë vendim të njoftohet Kryetari i Bashkisë Bulqizë, Ministria e Brendshme dhe Prefekti i Qarkut Dibër. Njësia Përgjegjëse të njoftojë çdo punonjës që është i emëruar në kundërshtim me ligjin dhe që është i evidentuar në këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha